

URDHËR
Nr. 889, datë 31.10.2024

PËR NGARKIM TË PËRKOHSHËM/ZËVENDËSIM NË DETYRË

Në mbështetje të pikës 4, të neneve 102, 118 dhe 119 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 43, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; pikës 3, nenit 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 209, datë 23.10.2024, “Për lirim nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”,

URDHËROJ:

1. Ngarkimin e përkohshëm të z. Ilir Ajdini, drejtor i përgjithshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, me qëllimin e garantimit të veprimtarisë së përditshmërisë administrative, deri në momentin e plotësimit të vakancës për këtë pozicion apo në një urdhër të dytë.
2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të AKVMB-së do të ushtrohen nga data 1.11.2024.
3. Ky urdhër nuk shoqërohet me efekte financiare.
4. Z. Ajdini ndalohet të nëndelegojë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen, z. Ilir Ajdini, drejtor i përgjithshëm i Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj